

VENDIM
Nr.210, datë 21.2.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË NJË KONTINGJENTI USHTARAK SLOVEN
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 16 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit të një kontingjenti ushtarak sloven përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 21 shkurt 2008 dhe kthim Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, më 28 shkurt 2008.

2. Kalimi transit do të bëhet i ndarë në disa faza, si më poshtë vijon:

- Në datën 21.2.2008 do të vijnë në Portin e Durrësit 73 automjete ushtarake, së bashku me 10 (dhjetë) shoferë.

- Në datën 21.2.2008, në orën 15.00, do të arrijnë në Aeroportin e Rinasit dhe do të shkojnë në Portin e Durrësit me autobus edhe 136 shoferë të tjerë.

- Mënyra e transitimit do të jetë me 4 autokolona, me nga 19, 18, 18 e 18 automjete, që do të nisen nga Porti i Durrësit, përkatësisht në orën 16.00, 16.30, 17.00 dhe 17.30. Autokolonat parashikohet të arrijnë në Qafë-Thanë në orën 19.00, 19.30, 20.00 dhe 20.30.

- Në datën 28.2.2008 do të hyjnë në Qafë-Thanë dhe do të shkojnë në Portin e Durrësit 27 automjete ushtarake.

- Mënyra e transitimit do të jetë me 2 autokolona, me 14 e 13 automjete. Autokolonat do të hyjnë në Qafë-Thanë, përkatësisht në orën 4.30 dhe 7.30 dhe parashikohet të arrijnë në Portin e Durrësit në orën 9.00 dhe 10.00.

3. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në “Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave”, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, në “Marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të “Marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

4. Kontingjenti sloven, gjatë itinerarit të lëvizjes nga Porti i Durrësit-Qafë-Thanë dhe Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, të shoqërohet nga njësi të Policisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha